




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/2282/18</u>
Nr. I faq _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>03.08.2018</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date _____
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.08.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-326/18, për zyrtarin e lartë z. Valdrin Kasumaj, Anëtar i Bordit në Trustin Pensional të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Valdrin Kasumaj, Anëtar i Bordit në Trustin Pensional të Kosovës dhe njëkohësisht Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim në Ndërmarrjen Publike "Infracos" Sh.A, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi, zyrtari i lartë është njoftuar se krahas ushtrimit të funksionit Anëtar i Bordit në Trustin Pensional të Kosovës nuk mund të ushtroj njëkohësisht edhe funksionin Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe



Zhvillim në Ndërmarrjen Publike "Infrakos" Sh.A, sepse kjo situatë është në kundërshtim me nenin 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në të cilën thuhet:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".

Gjatë procedurës së zhvilluar për konflikt interesi, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën atij i është kërkuar të heq dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjor, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 22 paragrafi 8 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pas kësaj, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/2182/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Valdrin Kasumaj është larguar nga ushtrimi i funksionit Drejtor i Departamentit në Ndërmarrjen Publike "Infrakos" Sh.A.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

